



## Përfundimet e Shibenikut: Përforcimi i kulturës së integritetit

Më 23 dhe 24 maj, në Shibenik të Kroacisë u zhvillua një konferencë ndërkombëtare, e cila kishte për qëllim shqyrtimin e mënyrave të përforcimit të kulturës së integritetit në Evropën Juglindore. Në këtë eveniment, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Administratës Publike të Republikës së Kroacisë dhe Iniciativa Globale kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, morën pjesë ministrat e drejtësisë dhe zyrtarë të tjerë të nivelit të lartë të fushës së drejtësisë dhe administratës publike, drejtuesit e autoriteteve të luftës kundër korrupsionit nga rajoni si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale, shoqërisë civile dhe akademisë.

Ministrat e drejtësisë konfirmuan përsëri angazhimin e tyre për të luftuar korrupsionin, duke ndjekur një qasje strategjike gjithëpërfshirëse të përqendruar te nismat dhe ndërhyrjet parandaluese të shënjestruara dhe te nismat dhe ndërhyrjet në fushën e drejtësisë penale.

Gjatë kësaj konference u ngritën disa çështje kyçe:

Asnjë vend nuk është imun ndaj korrupsionit. Prandaj, është e rëndësishme që shtetet të **mësojnë nga përvoja e shteteve të tjera** në trajtimin e këtij problemi. Konferenca e Shibenikut ishte mundësi e mirë që vendet e Evropës Juglindore të mësonin nga përvoja e njëri-tjetrit në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, duke përfshirë këtu edhe përvojat e Kroacisë si vend fqinj dhe anëtar i Bashkimit Evropian.

Gjatë kësaj konference u nënvizuan lidhjet gërryese midis krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe i ashtuquajturit "**korrupsion i organizuar**", i cili nënkupton përdorimin e pushtetit për përfitime financiare, politike ose sociale. Duke qenë se korrupsioni është faktor që e mundëson krimin e organizuar, u sugjerua që përpjekjet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të harmonizohen më mirë.

Ndonëse ka pasur përparim të konsiderueshëm në drejtim të ndjekjes penale të korrupsionit, duke përfshirë edhe rastet e korrupsionit të madh, ekziston nevoja e vazhdueshme për rivlerësim dhe përmirësim në këtë fushë shumë sfiduese dhe të rëndësishme.

Përforcimi i integritetit është një prej gurëve të themelit të **parandalimit të korrupsionit**. Në qendër të kuadrove kombëtare strategjike për luftën kundër korrupsionit duhet të ketë një përbërës të fuqishëm parandalues, duke përfshirë transparencën, qasjen në informacion, edukimin për luftën ndaj korrupsionit dhe mbrojtjen e informatorëve, me qëllim krijimin e zgjidhjeve sistemike për minimizimin e mundësive të korrupsionit në të gjitha nivelet shtetërore.

Në kuadër të përforcimit të kulturës së integritetit, në konferencë u theksua rëndësia e rritjes së vetëdijes për dëmin e korrupsionit dhe nevojën për raportimin e parregullsive. Këtu përfshihet edukimi për dukurinë

e korrupsionit, sidomos në shkolla dhe universitete, dhe organizimi i fushatave dhe evenimenteve publike që kanë për qëllim rritjen e vetëdijesimit për domosdoshmërinë e luftës kundër korrupsionit.

Në konferencë u vu në dukje rëndësia e **konventës së Kombeve të Bashkuara "Kundër korrupsionit"** (UNCAC), që është instrumenti më gjithëpërfshirës, detyrues (nga pikëpamja ligjore) dhe universal në luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, në konferencë u kujtua deklarata politike e titulluar "Angazhimi ynë i përbashkët për të adresuar në mënyrë efikase sfidat dhe për të zbatuar masat për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe për përforcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar", e cila u miratua me konsensus nga Konferenca e Shteteve Palë (7 maj 2021) dhe u miratua nga Asambleja e Përgjithshme më 2 qershor 2021 në sesionin e saj të posaçëm kundër korrupsionit. Krahas këtyre, u theksua edhe rëndësia e mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë në luftën kundër korrupsionit, p.sh. zbatimi i konventave të së drejtës penale dhe civile "Për korrupsionin" të Këshillit të Evropës (KIE) dhe i punës së organit "GRECO" të KIE-së për luftën kundër korrupsionit.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e angazhimit të të gjitha niveleve të shoqërisë për parandalimin e korrupsionit. **Shoqëria civile** dhe akademia luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë kontekst duke shtuar vlerë në procesin e politikëbërjes kundër korrupsionit, duke vlerësuar ndikimet e masave të zbatuara dhe duke zbatuar veprimtari edukative dhe veprimtari të tjera për rritjen e vetëdijesimit. Më tej, është tepër e rëndësishme të krijohet një hapësirë për shoqërinë civile dhe lirinë e medias me qëllim që korrupsioni të jetë në qendër të vëmendjes dhe që të ndërtohen ura bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe qeverisë në drejtim të përforcimit të integritetit.

Vendet e Evropës Juglindore kanë marrë përsipër një numër angazhimesh të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë edhe ato ndaj Bashkimit Evropian. Fuqia e këtyre angazhimeve qëndron në **zbatimin** e tyre. Pjesëmarrësit në konferencë nënvizuan rëndësinë e kornizave dhe proceseve të projektuara për të ndihmuar shtetet në realizimin konkret të angazhimeve të tyre dhe në përforcimin e llogaridhënies, duke përfshirë mekanizmin shqyrtues të UNCAC-së, Procesin e Berlinit dhe "Udhërrëfyesin rajonal për antikorrupsionin dhe financimet e paligjshme".

Efekti gërryes i korrupsionit ndikon te secili anëtar i shoqërisë duke cenuar kështu besimin tek institucionet publike, gjë që çon në dobësimin e shtetit ligjor. Prandaj, pjesë e luftës kundër korrupsionit duhet të bëhet çdo qytetar, në mënyrë që të tregohet se nuk ka tolerancë për korrupsionin. **Qasja mbarëshoqërore**, e diskutuar në Shibenik, thekson rëndësinë e lidhjes së elementeve thelbësore të shoqërisë me qëllim nxitjen e qasjeve të përbashkëta ndaj një problemi të përbashkët.

Zhvillimet e fundit teknologjike kanë bërë të mundur jo vetëm shfaqjen e tipave të rinj të veprave penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar, por edhe të një *modus operandi* të ri për komisionet e tyre dhe për fshehjen e të ardhurave nga veprimtaritë kriminale. Këto sfida bëhen të dukshme sidomos kur është fjala për kriptovalutat, prandaj kërkohet që agjencitë e zbatimit të ligjit të reagojnë në mënyrë efektive. Trajnimet sistematike, aparatet e përshtatshme dhe kuadri ligjor kanë rëndësi vendimtare në këtë drejtim. Këto elemente duhet të plotësohen me një bashkëpunim të përforcuar dypalësh dhe ndërkombëtar, kjo edhe në kuadrin e organizatave ndërkombëtare që përcaktojnë sfidat e përbashkëta dhe zgjidhjet e mundshme të përbashkëta.

Pjesëmarrësit theksuan edhe potencialin e shkencës, kërkimit shkencor dhe teknologjisë në drejtim të përmirësimit të transparencës.

Pjesëmarrësit në konferencë i shprehën vlerësimin e tyre të madh Ministrisë së Drejtësisë dhe Administratës Publike të Republikës së Kroacisë dhe Iniciativës Globale kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar për organizimin e këtij evenimenti të rëndësishëm në bregdetin kroat, dhe theksuan rëndësinë që paraqet përforcimi i **kulturës së integritetit**. Ata thanë se shpresonin që evenimente të ngjashme rajonale të organizoheshin edhe në të ardhmen.